

RAPORTI VJETOR 2024



Shtator 2024

INFORMACION PËR SHKOLLËN

Gjimnazi “Ali Demi”

DAR Vlorë

Adresa elektronike: www.gjimnazi-alidemi.edu.al

Gjimnazi “Ali Demi”, i pari gjimnaz në Vlorë, me mbi 75 vjet eksperiencë, mundësi dhe sukses.

MISIONI

Gjimnazi “Ali Demi” ofron mundësi arsimore të barabarta, hapësirë për të gjithë për të qenë në të njëjtin hap me zhvillimet, staf të kualifikuar dhe kushte bashkëkohore e efektive për t’u pajisur me njohuri e zhvilluar frymën kreative.

VIZIONI

Gjimnazi “Ali Demi” do të jetë gjimnazi i rezultateve më të larta, jo vetëm në Vlorë, do të jetë hapësira ku stimulohet e zhvillohet talenti, shpirti konkurues e novator i të rinjve, vendi ku edukohen personalitete me qëllime të qarta e të gatshëm për sfidat e jetës, të aftë për përparimin, qytetarë të denjë të së ardhmes.

- Ashtu siç janë paraqitur edhe në Planin Vjetor të Zhvillimit të Shkollës për vitin shkollor 2023-2024, objektivat tona kanë qenë:

1. Cilësia e notës në provimet e MSh 2024 të jetë mbi 8.25

2. Ulja e numrit të mungesave pa arsye në masën 2m për nxënës, krahasuar me VSh 2022-2023.

Objektivi i parë u arrit, pasi nota mesatare e provimeve të MSh 2024 ishte 8.5.

Përsa i përket objektivit të dytë, ai nuk u arrit pasi numri i mungesave këtë vit shkollor ishte 14 m/nxënës.

- Kontribut i arkëtuar- 645 500 lekë të rinj (sipas mandat pagesave)
Donacione (White boards) në vlerën 617 000 lekë të rinj
Shpenzime 644 349 lekë të rinj (sipas PV, faturave, kuponëve tatimore, regjistrat të bankës).
- Viti i kaluar e renditi gjimnazin tonë në vendin e pestë për rezultatet e MSH 2023, në nivel kombëtar.
- E veçantë për gjimnazin janë bursat e përfituara nga ITU, Stamboll, (8 bursa) dhe Sllovakia (1 bursë).
- Me interes është vijimësia e klasës së Inteligjencës Artificiale dhe projekti RYCO, ku u shpallëm fitues.
- Numri i fituesve të shkollës në konkurimet e ZVA, ishte 48 nxënës fitues, konkretisht, 16 vende të para, 14 vende të dyta dhe 18 vende të treta, rezultate këto, të kënaqshme.
- Për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor duhet patjetër t'i kushtohet rëndësi zhvillimit profesional të mësuesve për të qenë në koherencë me ndryshimet kurrikulare, efektivitetit të rrjeteve profesionale e komisioneve lëndore. Ajo që do të jetë në fokusin e punës sonë ka të bëjë me laboratorët, vënien në efikasitet të tyre, për të mos qenë vetëm në pozita demonstruese.
- Gjithashtu, në vitin që kaloi, u ngrit muzeu i shkollës, të cilin, e vlerësojmë si një element që do të përmirësojë performancën e shkollës.

Grupi i punës për hartimin e Raportit Vjetor të gjimnazit “Ali Demi”

1. Roland Dervishaj

2. Gladiola Trushaj

3. Julinda Dukagjini

4. Eldiona Shahaj

5. Asllan Azizaj

6. Armela Fyraj

